



Terminali vetë-shërbyes është dizajnuar për t'i mundësuar studentëve t'i marrin dy shërbime të mëposhtme:

1. Vërtetimin/certifikatën e studentit
2. Certifikatën e notave (transkripta e notave)

Certifikata e printuar merret në zyrën e sigurimit, ngjitur me terminalin.

Shërbimet nga Terminali Vetë-shërbyes mund të merren 24/7.

Terminali është dizajnuar dhe prodhuar nga studentët e UShAF-it për
studentët e UShAF-it.

PËRDORIMI I TERMINALIT

Hapi 1. Qasja në sistem: Qasuni në sistem duke përdorur numrin e dosjes dhe fjalëkalimin, të njëjtët që përdorni për hyrje në **SMIS** (Sistemi për Menaxhimin e Informatave të Studentëve). Figura 1.




Figura 1.

Hapi 2: Zgjidhni dokumentin që dëshironi të printoni (vërtetim ose certifikatë notash), duke klikuar butonin përkatës. Figura 2.




Figura 2.

Sqarim:

1. Nëse mungon butoni për printimin e vërtetimit

Nëse nuk shfaqet butoni për **printimin e vërtetimit të studentit**, kjo nënkupton se **nuk e keni të regjistruar semestrin dimëror 2025/2026**.

Çfarë duhet të bëni: Në këto raste, studenti duhet paraprakisht të paraqitet në administratë për ta kryer regjistrimin e semestrit si përsëritës.

2. Nëse mungon butoni për printimin e certifikatës së notave

Nëse nuk shfaqet butoni për **printimin e certifikatës së notave (transkriptës)**, kjo nënkupton se **nuk keni kryer pagesën për certifikatën**.

Çfarë duhet të bëni:

1. Kryeni paraprakisht pagesën për certifikatën e notave;
2. Konfirmoni pagesën në administratë;
3. Pas konfirmimit, mund të printoni certifikatën nga terminali vetëshërbyes.

Hapi 3. Shkruani arsyen e printimit të dokumentit përkatës (p.sh. për aplikim në punë, për ndonjë institucion, për studime, etj.), dhe për të vazhduar klikoni butonin “Vazhdo” Figura 3.

Figura 3.

Hapi 4. Klikoni butonin “Printo”, pa ndryshuar konfigurimin e printerit. Figura 4.

⚠ Mos ndryshoni konfigurimin (settings) e printerit.

Çdo ndryshim në cilësimet e printerit mund të ndikojë në funksionimin normal të terminalit.




Figura 4.
Suksese!